



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

**RAPORT I GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2024 PËR PROCESIN E
KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

1. Përmbledhje ekzekutive

Për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ka miratuar 4 projekt-akte objekt i konsultimit publik sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, si dhe Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2024, ndër të cilët 3 (tre) prej tyre janë konsultuar, konkretisht;

-Projektligji “Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji”, miratuar me ligjin nr. 52/2024;

- Projektligji “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me ligjin nr. 54/2024;

-Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar”, i cili ndonëse nuk ishte parashikuar në planin e konsultimit, u konsultua dhe u miratua me ligjin nr. 41/2024;

Përgjatë kësaj periudhe raportimi janë zhvilluar konsultime publike dhe për 3 (tre) projekt-akte të tjera të cilat do të paraqiten për miratim në periudhën e ardhshme të raportimit, siç janë:

1. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”,
2. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 90/2021, “Për ndarjen e shoqërisë “Hekurudha Shqiptare sh.a””,
3. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar””.

Krahasuar me vitin e kaluar ministria ka performuar më mirë lidhur me këtë proces, duke diversifikuar metodat e përdorura për konsultim publik dhe duke i përzgjedhur ato në varësi të kompleksitetit të akteve.

Një problematikë që vlen të theksohet është se ka shumë vizitorë, si nga qytetarë dhe ekspertë por janë të pakët ata që lënë komente në portalin e Regjistrimit Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike. Megjithatë, qytetarët/ekspertët kanë pasur mundësi dhe rrugë të tjera, si përshembull adresën e-mail për të përcjellë shqetësimet dhe paqartësitë e tyre.

2 Analiza e konsultimeve të kryera gjatë gjashtë muhorit të parë të vitit 2024

2.1 Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Numri i përgjithshëm i akteve për të cilin Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka kryer konsultim publik gjatë gjashtëmuhorit të parë të vitit 2024 është 3 (tre), konkretisht:

1. Projektligji “Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji”, miratuar me ligjin nr. 52/2024,
2. Projektligji “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me ligjin nr. 54/2024,
3. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar”.

2.1.1 Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

MIE ka miratuar 101 akte në gjashtëmuhorin e parë të vitit 2024, 94 projektvendime të Këshillit të Ministrave të miratuara me propozim të ZVKM dhe MIE, 2 projektligje për ratifikim marrëveshje ndërkombëtare dhe 4 projektligje objekt i konsultimit publik, 1 akt normativ, me fuqinë e ligjit.

2.1.2 Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

3(tre) projektakte i janë nënshtruar konsultimit publik dhe 1 (një) nuk i është nënshtruar procesit të konsultimit publik. Në lidhje me pjesën tjetër të akteve të cilat janë miratuar, konkretisht 94 prej tyre, nuk kanë qenë objekt i konsultimit publik në përputhje me parashikimet e ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

2.1.3 Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

- Janë konsultuar 2 (dy) projektakte:
 - Projektligji “Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji”,
 - Projektligji “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.


2 (dy) prej akteve të miratuara gjatë kësaj periudhe nuk janë objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit, sipas përcaktimeve të pikës 45/1, shkronja a) në Kreun VI të VKM nr. 584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar, që përcakton se përjashtohen nga detyrimi i kryerjes së vlerësimit të ndikimit.

2.1.4 Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

- Për 25 aktet e parashikuara në Programin Analitik gjatë vitit 2024, për 18 prej tyre janë përdorur kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, pasi nuk janë në listën shteruese për të cilën është i detyruar konsultimi publik.

- Nga 14 aktet e parashikuara në PKIE, për 10 prej tyre aplikohen kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik sipas përcaktimeve të Ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.
- Nga 17 aktet e parashikuara në dokumentat strategjike kombëtare dhe sektoriale, për 12 prej tyre aplikohen kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Grafik 1: Përdorimi i kriterëve të përjashtimit nga konsultimi publik



2.1.5 Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Aktet e miratuara, objekt i konsultimit publik, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2024, ishin projektligje. Më konkretisht:

- Projektligji “Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji”,
- Projektligji “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar”.

2.1.6 A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Krahasuar me performancën institucionale të gjashtë mujorit të parë të vitit të kaluar MIE ka realizuar një proces më efektiv konsultimi publik për projektligjet e miratuara, duke qene se në periudhën krahasuese është konsultuar vetëm një projektligj.

2.2 Metodat e konsultimit

2.2.1 Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

- Metodatat e përdorura për konsultimin publik për projektligjin “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”ishin:
 1. Publikimi i projektaktit dhe paketës shoqëruese, 31 Tetor 2022, në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (RENJKP);
 2. Publikimit të projektaktit dhe paketës shoqëruese në website zyrtare të MIE, 31 Tetor 2022;
 3. Tryezë takimi konsultimi me ekspertë me përfaqësues të AKEP, Korrik 2022;
 4. Workshop me ekspertë përfaqësues të institucioneve publike dhe private, 7 Korrik 2022;
 5. Takimi konsultativ me operatorët e telekomunikacioneve, 19 shtator 2022;
 6. Ndërmjet postës elektronike: vilma.davidhi@infrastruktura.gov.al; fotjon.kosta@infrastruktura.gov.al;
 7. Tryezë e rrumbullakët, me pjesëmarrjen e aktorëve të interesuar, si operatorët Vodafone, One Telecommunications, Digicom, Digitalb, Tring, Albania Fiber Telecommunications, Abissnet sh.a, etj, pranë ambjenteve të MIE, 22 Nëntor 2022;
 8. Tryezë e rrumbullakët, me pjesëmarrjen e institucioneve publike, si AMA, AKEP, ACESK, KDIMP, AK, Ministrinë etj, datë 22 Nëntor 2022, pranë ambjenteve të MIE.
 9. Projektligji i rishikuar pas konsultimeve i publikuar në faqen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me datë 12.9.2023;
 10. Takime sqaruese me operatorët e telekomunikacioneve në nëntor 2023;
 11. Konsultim me Shërbimet e Komisionit Evropian gjatë vitit 2023.

- Metodatat e përdorura për konsultimin publik për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar”
 1. Publikimit të projektaktit më datë 30 Nëntor 2022, në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike;
 2. Publikimit të projektaktit në website zyrtare të MIE datë 13 Dhjetor 2022 dhe paketës shoqëruese;
 3. Ndërmjet postës elektronike të koordinatores për njoftim dhe konsultim publik.

- Metodatat e përdorura për konsultimin publik për projektligjin “Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji”, ishin:
 1. Publikimit të projektaktit më datë 15 Nëntor 2022, në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike;
 2. Publikimit të projektaktit në website zyrtare të MIE datë 13 Dhjetor 2022 dhe paketës shoqëruese;
 3. Ndërmjet postës elektronike të koordinatores për njoftim dhe konsultim publik.

2.2.2 Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte ajo e takimeve konsultative me aktorët e interesuar, 20 komente. Përmes konsultimit publik nëpërmjet emailit dhe regjistrimit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike dhe përmes publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nuk ka pasur komente.

2.2.3 A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Po, për projektligjin “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, janë organizuar 7 takime në kuadër të fazës së konsultimeve paraprake. Pjesëmarrësit në këto takime ishin përfaqësues të AKEP, Autoritetit të Medias Audiovizive, Autoriteti i Medias Audiovizive, Autoriteti i Konkurrencës, AKCESK, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave, Agjencia Kombëtare e Emergjencave Civile, AKSHI, operatorët e telekomunikacioneve.

Për dy aktet e tjera nuk janë organizuar konsultime paraprake.

2.3 Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1 Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Konsultimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP) për projektligjin “Për komunikimet elektronike”, u zhvillua me kohëzgjatje prej 22 ditësh pune, për periudhën nga data 31 Tetor 2022 deri në datën 30 Nëntor 2022, gjatë së cilës nuk janë përcjellë komente përmes këtij portali.

Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar”, konsultimi në RENJKP, u zhvillua me kohëzgjatje prej 20 ditësh pune, për periudhën nga data 30 Nëntor 2023 – 28 Dhjetor 2023, gjatë së cilës nuk janë përcjellë komente përmes këtij portali.

Projektligji “Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji”, konsultimi në RENJKP, u zhvillua me kohëzgjatje prej 20 ditësh pune, për periudhën nga data 15 Nëntor 2023 – 13 Dhjetor 2023, gjatë së cilës nuk janë përcjellë komente përmes këtij portali.

2.3.2 Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit përsa i përket fazave paraprake dhe më pas publikimit në RENJK, është 9 (nëntë) muaj.

2.3.3 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Krahasuar me performancën institucionale të gjashtë mujorit të parë të vitit të kaluar MIE për periudhën e raportimit ka realizuar një proces efektiv konsultimi publik për projektligjet e miratuar dhe ka respektuar afatet e publikimit në RENJKP.

2.4 Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Për projektligjin “Për komunikimet elektronike”, ka pasur një numër të konsiderueshëm i aktorëve të jashtëm, kryesisht ekspertë të fushës së telekomunikacinit, 10 përfaqësues të institucioneve shtetërore, Organet Rregullatore, ekspert të BE, etj ishin pjesëmarrës në procesin e hartimit.

Për projektligjet “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar” dhe “Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji”, aktorët të interesuar kanë qenë përfaqësues të institucioneve shtetërore, Organet Rregullatore etj.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Për konsultimin e projektakteve gjatë vitit 2024, pjesëmarrësit ishin:

- Ekspertë,
- përfaqësues nga organet rregullatore,
- përfaqësues nga institucione publike të pavarura apo institucione të varësisë,
- përfaqësues nga këshillat konsultativ,
- përfaqësues nga Komisioni Europian,
- përfaqësues nga aktorët e interesuar.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Gjatë procesit të konsultimit publik kanë dhënë komente dhe kontribute 20 grupe interesi, ku përfshihen kryesisht operatorët e telekomunikacioneve, si nga “Albtelecom”, “One Albania”, “Vodafone Albania”, “Abissnet”, “Tring”, “Digicom”. Komente me shkrim kanë ardhur dhe nga “AKCESK”, KDIMP, AK, dhe AKSHI.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Struktura e përfaqësuesve kontribues në konsultimet publike ishin:

1. Operatorët e telekomunikacioneve,
2. Organet rregullatore,
3. Insitucionet e varësisë,
3. Këshillat konsultativ.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Situata për gjashtëmujorin e parë 2024 paraqitet e njëjtë me vitin e kaluar. Procesi i konsultimi ka qenë proaktiv dhe gjithëpërfshirës, duke zhvilluar konsultime të fazuara dhe mundësuar kështu pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesit.

2.5 Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1 Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Në regjistrin e konsultimeve publike nuk ka pasur komente/sugjerime nga aktorët e interesuar, por kanë paraqitur komente me shkrim institucionet shtetërore si AKCES, KDIMP, AK, dhe AKSHI për projektligjin “Për komunikimet elektronike” .

2.5.2 Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Për projektaktet e konsultuara gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2024 numri total i komenteve të përcjella ka qenë 20 prej të cilave:

- 2 të pranuar plotësisht;
- 10 të pranuar pjesërisht;
- 8 të refuzuara.

2.5.3 Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Konstatohet se tendenca ka mbetur e njëjtë me vitin e kaluar.

2.5.4 Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Asnjë raport VNR nuk është ndryshuar apo përditësuar në bazë të informacionit të marrë gjatë konsultimit publik pasi kontributet e mbledhura nuk ndryshojnë thelbin e nismës.

2.6 Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1 Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Për vitin 2024 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka publikuar 3 (tre) raporte individuale konsultimi.

2.1.1 Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Të gjitha raportet individuale të konsultimit të hartuara për aktet e miratuara dhe të konsultuara gjatë kësaj periudhe janë publikuar në RENJKP dhe faqen zyrtare të ministrisë.

2.7 Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Duke marrë në konsideratë metodologjinë e pikëzimit “Projektligjet publikohen në sistemin e informacionit të qeverisë, është dhënë informacion i mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit; janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre, në draftin e ri pasqyrohet dhe reflektohet reagimi të palëve të interesuara”, konsultimi publik për projektligjet, vlerësohet me 6 pikë.

2. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Për sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik mund të përmendim gjithpërfshirjen e publikut, ndërmjet një angazhimi më të madh në këtë proces. Me qëllim përmirësimit e procesit të konsultimit publik, sugjerohet organizimi i konsultimeve përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik.